

Mbijetesa e Mishngrënësve të Mëdhenj në duart tona **Ariu, ujku dhe rrëqebulli**

Olsi Qazimi - PPNEA

Asnjeri nuk e di se sa i vjetër është konflikti mes njerëzve dhe grabitqarëve të mëdhenj në Shqipëri, por dihet se shfarosja masive kafshëve të egra zë fill në vitet e para të shekullit të kaluar. Historia e popullit shqiptar, që shquhet për blegtorët e devotshëm ndër qindra shekuj, na tregon një konflikt të hershëm dhe të stabilizuar midis barinjve që mbarështonin bagëti dhe mishngrënësve të mëdhenj të pyjeve. Grabitqari më i rrezikshëm dhe më i tmerrshëm për bagëtitë ka qenë dhe vazhdon të jetë ujku, i cili zë vendin e parë për dëmet e shkaktuara në blegtori. Ariu shquhet kryesisht për dëmet në të mbjella ndërsa bagëtitë i sulmon rrallë. I fundit për nga ndikimi në dëmet blegtorale është rrëqebulli, i cili edhe pse është një grabitqar tejet efikas, ka një popullatë mjaft të vogël dhe sulmet e shkaktuara prej tij janë të papërfillshme në krahasim me ato të ujqrëve dhe arinjve.

Nga një studim paraprak i ndërmarrë nga Shoqata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri, lidhur me konfliktet midis njerëzve dhe mishngrënësve të mëdhenj, rezultoi se në 46 fshatra të thellë malorë në 12 muajt e fundit, janë sulmuar dhe vrarë nga ujku rreth 949 kokë dhen, 43 lopë dhe 51 kafshë transporti (kuaj, gomarë dhe mushka). Nëse përmenden dhe dëmet e shkaktuara nga ariu në të mbjella, koshere bletësh dhe bagëti dhe të dhelpres në shpendë shtëpiakë, dëmi material i llogaritur do të ishte rreth 170 mijë euro.

Nga ana tjetër përgjigjja e njerëzve nuk ka qenë më e mëshirshme. Në territorin e fshatrave të marrë në studim, gjatë 5 viteve të fundit, janë vrarë me metoda të ndryshme, si armë zjarri, helmim, leqe, kurthe dhe çarqe 38 ujqrë dhe 23 arinj. Gjatë vëzhgimeve të ndërmarrë në terren janë numëruar 17 arinj të balsamosur e të vendosur nëpër restorante si atraksione turistike dhe ornamente zbukurimi. Shifrat janë alarmante edhe pse dihet që ariu është specie e mbrojtur me ligj. Dihet që numri i mishngrënësve të vrarë është shumë më i madh edhe pse është vështirë të konfirmohet pasi, në shumë raste, fshatarët nuk tregojnë sepse kanë frikë nga përgjegjësitë penale. Çudia nuk merr fund këtu. Në një fshat në rrethin e Librazhdit shitet mish ariu me 10 euro kilogrami, kurse në kopshte zoologjike të paligjshme, si në Gjermani, Voskopojë dhe Rrushkull mbahen të burgosura në kushte mjerueshme kafshë të mbrojtura me ligj. Kudo nëpër restorante të ashtuquajtura gjahtarësh, në të cilët drekojnë madje dhe deputetë, ministra e kryetarë shtetesh, shikon të reklamuar në mure si trofe të gjitha llojet e kafshëve të mbrojtura e të pambrojtura nga ligjet shqiptare apo konventat ndërkombëtare. Në zonat e mbrojtura me ligj dhe ku gjuetia është rreptësisht e ndaluar, mund të gresh në çdo orë të ditës apo të natës, gjahtarë të huaj e shqiptarë që gjuajnë pa ju dridhur qerpiku fare. Nga të dhënat e federatës së gjuetarëve rezultoi se për çdo 250 m² të territorit shqiptar ka një armë zjarri.

Mjaft fshatarë apo gjuetarë të pyetur gjatë studimit konfirmojnë se kohët e fundit sulmet e grabitqarëve të mëdhenj si ujku dhe ariu ndaj bagëtive janë shtuar. Por kjo nuk do të thotë se numri i grabitqarëve të mëdhenj në Shqipëri është shtuar, në kundërshtim me atë çka besojnë shumë njerëz. Arsyeja është mjaft e thjeshtë: Për mishngrënësit e mëdhenj nuk ka mbetur me ushqim natyror

në pyjet shqiptare, siç është kaprolli, dhia e egër, derri i egër, lepuri, etj., kjo pasi këto kafshë janë shfarosur ose po zhduken dita-ditës nga gjuetarët (e ligjshëm apo të paligjshëm) dhe nga prerja pa kriter e pyjeve. Në mënyrë që të mund të zbusim konfliktin njeri-mishngrënës duhet të mbrojmë habitatet dhe gjahun e tyre. Dikur, atëherë kur nuk ishin shpikur armët e zjarrit, blegtorët i ruanin tufat e tyre me disa qen të mëdhenj të racës shqiptare të mbarështuar vetëm për qëllimin e mbrojtjes së bagëtive. Kjo traditë mund të jetë mjaft efiçase dhe në kohërat tona dhe do të shmangte përdorimin e armëve të zjarrit në mjaft raste.

Por faji nuk bie tërësisht mbi blegtorët. Shpesh ata e shfajsojnë veten duke përmendur dëmet që shkaktajnë mishngrënësit në gjënë e gjallë e të mbjella dhe mungesën e kompensimit nga ana e shtetit. Ata nuk kanë ku të ankohen, sepse nuk ekziston një ligj apo strategji kompensimi nga shteti, për dëmet e shkaktuara nga kafshët e egra. Në shumë vende të Evropës, ka ligje të konsoliduara për kompensimet të dëmeve të shkaktuara nga mishngrënësit e mëdhenj. Kjo gjë ka ulur ndjeshëm konfliktin midis fermerit dhe mishngrënësve, kështu dhe impaktin e njeriut ndaj faunës së egër.



E vërteta është se vrasja e mishngrënësve të mëdhenj nga blegtorët apo gjuetarët është bërë, ndër të tjera, dhe një biznes fitimprurës. Në tregun e zi, një lëkurë ariu

kushton 1000 euro, një ujku i balsamosur që mund të shitet kudo (edhe te Zogu i zi në Tiranë) kushton 350 euro kurse rrëqebulli (specie rreptësisht e mbrojtur nga ligji dhe e rrezikuar nga zhdukja) është i preferuar për tregun e jashtëm, si në Kosovë dhe Mal të Zi. Këto të dhëna i japin vetë fshatarët që në mjaft raste, kanë nostalgji për pyjet e dikurshme të mbushura plot me kafshë të egra.

Ligji për mbrojtjen e ariut dhe të rrëqebullit nuk zbatohet. Ligji për kompensimin e fermerëve për dëmet e shkaktuara nga mishngrënësit e mëdhenj nuk ekziston. "Kompromisi" dhe "zgjidhja" e vetme në konfliktin njeri-mishngrënës deri në ditët tona ka qenë vetëm pushka. Është absolutisht e domosdoshme të ndërmerren masa të menjëhershme për frenimin e kësaj "lufte" të pabarabartë. Shumë njerëz do të dëshironin që ujku, ariu dhe rrëqebulli të mos jetonin më në pyjet shqiptare pasi kjo do të zgjidhte konfliktin me blegtorinë. Por a është kjo një zgjidhje? Këto kafshë janë një pasuri e natyrës shqiptare dhe bartin vlera të mëdha ekologjike dhe natyrore. Biodiversiteti i Shqipërisë do të pësonte një humbje të madhe me zhdukjen e tyre. Rruga më e mirë do të ishte bashkëekzistenca paqësore. Duhet marrë masat e nevojshme dhe të duhura në mënyrë që konflikti të zbutet dhe njëkohësisht natyra të mos pësojë humbje.

Të gjithë ne kujtojmë legjendat me ujqrë dhe arinj që na tregojnë prindërit kur ishim të vegjël. Ne duhet të mbrojmë këto kafshë, jo vetëm sepse janë pasuri e natyrës dhe pjesë të rëndësishme të ekosistemit, por edhe pse ato kanë patur te ne një ndikim dhe formim emocional dhe shpirtëror. Nuk mund të kuptohet një pyll apo një mal pa ariun dhe ujkun. Që fëmijët tanë të vazhdojnë të tregojnë legjendat fëmijëve të tyre, le ti pranojmë paqësisht këto kafshë dhe ti shpëtojmë nga rreziku i zhdukjes.